

shpejt dhe me qerren e bartën Ibrahimin në spitalin e Gjakovës/Đakovica. Mjekët atje i dhanë ndihmën e parë, por për shkak të dëmtimeve të rënda e dërguan për në Prishtinë/Priština. Ka ndërruar jetë më 14.07.1998. Doktorin Avdyl Shoshi e ka varrosur në varrezat e Dragodanit në Prishtinë/Priština. Pas lufte, doktor Shoshi i ka treguar familjes vendin ku ishte varrosur Ibrahimin, por ata atje e gjetën vetëm një gropë. Trupi i Ibrahimit ishte zhdukur. Nuk është gjetur deri më sot.

**Burimet:** deklarata M.Z, FDH-40626; J. Osmani, *Krimet...*, I, 306.

### Kujtim (Binak) Imeraj

(8.03.1980, egjiptian nga fshati Palabardhë/Palja Barda, komuna e Gjakovës/Đakovica, i papunë)

Kujtimi me familje jetonte në fshatin Palabardhë/Palja Barda. Në pranverë të vitit 1998, ai me familjarë kanë kaluar në **Novosellën e Re të Ulët/Donje Novo Se-Lo**. Atë botë, forcat serbe nisën të ndërhyjnë kohë pas kohe në Palabardhë/Palja Barda. Në datën **4.07.1998**, diku nga mesdita, Kujtimi kishte dal për të blerë cigare. U takua me një grup burrash të armatosur, një nga të cilët ishte i veshur në uniformën e zezë. Grupi paska ardhur nga drejtimi i Dujakës/Dujak dhe Glllogjanit/Glodane. E kërkonin Kujtimin, por edhe babanë e tij Binakun. Pasi e ndalën, Kujtimin e futën në makinë duke e qëlluar me kondakët. E çuan në drejtim të Dujakës/Dujak dhe Glllogjanit/Glodane. Një kohë të gjatë, familjarët nuk dinin asgjë për fatin e Kujtimit. Më në fund, më 17.07.2007, mbetjet e tij mortore i janë dorëzuar familjes. Ato ishin zbuluar nga mesi i muajit shtator të vitit 1998 jo shumë larg nga *Liqeni i Radoniqit/Radoničko jezero*. Pas gjetjes së tyre, mbetjet e tij mortore kishin qenë të varrosura në fshatin Piskotë/Piskot. Familjarët e kanë varrosur Kujtimin në varrezat Jasikovac në Berane, në Mal të Zi.

**Burimet:** deklarata N.I, FDH-18680; deklarata D.I, FDH-4579; ICTY, IT-04-84 (R. Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 3.04.2008, 169-170, FDH-27349; AFPRRZHKem, *Regjistri i personave...*, FDH-16116.

### Avni (Osman) Avdimetaj

(25.03.1968, shqiptar nga Strellci i Epërm/Gornji Streoc, komuna e Deçanit/Dečani, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Avniu aderoi në UÇK më 25.05.1998, në shtabin e saj në Strellcin e Epërm/Gornji Streoc. Ka marr pjesë në mbrojtjen e fshatit, por ishte i ngarkuar edhe me furnizimin e ushtrisë me armatime. Gjatë një aksioni të tillë, i cili u ndërmor më **5.07.1998**, grupi i cili e bartte një ngarkesë armatimesh nga Shqipëria në Kosovë, në të cilin bënte pjesë edhe Avniu, ka rënë në pritë të forcave serbe te postblloku ushtarak **Koshare/Košare**. Avniu e qëlluan për vdekje në vend. Bashkëluftëtarët e kanë tërhequr trupin e tij nga vendi i ngjarjes dhe e kanë varrosur në Strellcin e Poshtëm/Donji Streoc. Avniu u rivarros në varrezat e fshatit të Strellcit të Epërm/Gornji Streoc, më 28.08.1998.

**Burimet:** H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### Ali (Xhemë) Rrustemi

(15.12.1973, shqiptar nga Babaj i Bokës/Babaj Boks, komuna e Gjakovës/Đakovica, punëtor, i pamartuar)

Aliu jetonte në bashkësi familjare me nënën dhe vëllain Halimin me familje. Askush nuk e kishte parë Aliun, kur ai më **5.07.1998**, ka dal nga shtëpia. Halimi u nis për në Gjakovë/Đakovica dhe rrugës ka mësuar se policia e kishte plagosur Aliun në fshatin **Duzhnjë/Dužnje**. Po ashtu, ka mësuar se e kishin bartur në spitalin e Gjakovës/Đakovica. Atje, e ka gjetur të vëllain që e ruanin policët. Kishte vërejtur se Aliu ishte i plagosur në gjoks. Aliun dy herë e kishin nënshtruar ndërhyrjeve kirurgjikale. Ka ndërruar jetë nga plagët më 12.07.1998. Familjarët e kanë varrosur në pyll. Pas lufte, ekspertët ndërkombëtar për mjekësinë ligjore e kanë zhvarrosur trupin e Aliut më 1.07.1999 dhe e kanë çuar në Institutin për Mjekësinë Ligjore në Rahovec/Orahovac. Djali i vëllait të Seferit, Salihut, i ka marr mbetjet mortore të Aliut dhe i ka rivarrosur më 24.08.2000 në varrezat e fshatit Babaj i Bokës/Babaj Boks.